



## KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

### PERMBAJTJA

Faqe

I.	Përmbledhje Ekzekutive .....	1-2
II.	Hyrje.....	2-4
	a. Objektivat dhe qëllimi	
	b. Identifikimi i çështjes	
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
	d. Përgjegjësitë e audituesve	
	e. Kriteret e Vlerësimit	
	f. Standardet e auditimit	
III.	Përshkrimi i auditimit.....	4-16
III. 1.	Në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit (DRM) Elbasan.....	4-7
III. 2.	Në Zyrën Vendore të ASHK Tropojë (ish-ZVRPP) Tropojë .....	7-15
III. 3.	Në Drejtorinë Vendore të të ASHK Bulqizë (ish-ZVRPP) Bulqizë.....	15-16
IV.	Dokumentacion shoqërues.....	16-16

### I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Nga auditimi mbi zbatimin e masave të rekomanduara nga KLSH, gjatë auditimeve të evaduara në vitin 2019 sipas programeve të auditimit me sipas programeve me nr. 316/6, datë 23.04.2020 dhe nr. 316/18, datë 23.04.2020 miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Shtetit si dhe në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Kryetarit nr. 1, datë 04.11.2016 "Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit", Udhëzimit nr. 1 datë 16.04.2020 "Mbi zhvillimin e veprimtarisë audituese gjatë kohëzgjatjes së fatkeqësisë natyrore" në subjektet e audituar: Drejtorinë Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK)Bulqizë (ish-ZVRPP Bulqizë), Zyra Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ZVASHK) Tropojë (ish-ZVRPP Tropojë) dhe në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit (DRM) Elbasan, ka rezultuar si më poshtë:

**a.**Janë rekomanduar gjithsej 102 **masa**, nga të cilat janë pranuar 92 **masa** ose 90,2 %, si dhe nuk janë pranuar 10 **masa** ose 9,8 %.

**a.1.** Niveli i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton: zbatuar plotësisht 74 **masa** ose 73 %, zbatuar pjesërisht 7 **masa** ose 7% %, si dhe 16 **masa** të pa zbatuara ose 15,6 %.

*a.1.1 Niveli i realizimit të masave sipas llojit të tyre, paraqitet si më poshtë:*

**-Masa organizative:** Nga 88 **masa** të rekomanduara, janë pranuar 78 ose 88,6% dhe 10 **masë** e pa pranuar ose 11%. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 71 **masa** ose 91 %; pjesërisht 5 **masa** ose 6 %, si dhe 12 **masa** të pa zbatuara ose 15%.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

- Masa me efekt negativ financiar (3E) "Të ardhura të munguara": Nga 4 masa të rekomanduara, janë pranuar 4 masa ose 100%. Nga masat e pranuar janë zbatuar pjesërisht **2 masa**, si dhe 2 masa të pa zbatuara.

**-Zbatimi në vlerë është si vijon: 4 masa** të rekomanduara me vlerë **222, 293 mijë lekë,**

**77,956 mijë lekë,** nga të cilat janë pranuar 4 **masa** me vlerë **222, 293 mijë lekë** ose **100 %**, si dhe asnjë masë të pa pranuar. Nga masat e pranuar, janë zbatuar vetëm pjesërisht **2 masa** me vlerën **50 mijë lekë,** ose **2 %**.

**-Masa disiplinore:** Nga 10 **masa** të rekomanduara, janë pranuar 10 **masa** ose **100 %** dhe asnjë masë të pa pranuar. Nga masat e pranuar janë zbatuar 3 **masa** ose **30 %** dhe 7 **masa** të pa zbatuara ose **70%.**

## II. HYRJE

Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Drejtorinë Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) Bulqizë (ish-ZVRPP Bulqizë), Zyra Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ZVASHK) Tropojë (ish- ZVRPP Tropojë) dhe në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit (DRM) Elbasan që lidhen me: Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Mbështetur në Ligjin 154/2014 Datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH", në zbatim të Programeve të Auditimit nr. 316/6, datë 23.04.2020, nr. 316/18, datë 23.04.2020, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 23.04.2020 deri në datë 12.05.2020, në subjektet Drejtorinë Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) Bulqizë (ish-ZVRPP Bulqizë), Zyra Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ZVASHK) Tropojë (ish- ZVRPP Tropojë) dhe në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit (DRM) Elbasan mbi auditimet e kryera në subjektet e sipërpërmendur u krye auditimi "Mbi Zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme", nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. Selfo Zeneli, përgjegjës grupi
2. Aleksandër Papadimitri, anëtar
3. Artan Vokshi, anëtar.

**- Objektivat dhe qëllimi i auditimit:** Kontrolli i Lartë i Shtetit ka audituar zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme, në lidhje me konstatimet e gjetjeve nga auditimi në përputhje e zbatim me nenet 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";

-ligjin nr. 8379, datë 29.07.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave;

-ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktive në njësitë e sektorit publik"; ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat", si dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.

**Qëllimi i auditimit** është vlerësimi objektiv, profesional e i pavarur i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

## Identifikimi i Çështjeve

**1.** Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

**1.1.** Respektimi i afatit ligjor prej 20 ditësh, për informimin e KLSH mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETETEVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

**1.2.** Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna.

**1.3.** Realizimi i rekomandimeve për *masa me karakter organizativ*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar.

**1.4.** Realizimi i rekomandimeve për *zhdëmtimin e dëmeve ekonomike*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar

**1.5.** Realizimi i rekomandimeve për *masa disiplinore dhe administrative*, sipas cilësimeve në planin e veprimeve të hartuar nga subjekti i audituar.

## 2. Probleme të ndryshme të dala gjatë auditimit

### **Gjendja aktuale e çështjes së shqyrtuar**, gjatë ushtrimit të auditimit online (në terren):

Për çështjet e shqyrtuara janë mbajtur sipas rastit aktkonstatime ose aktverifikim për çdo subjekt të audituar. Gjithashtu janë zhvilluar ballafaqime gjatë auditimit online dhe në përfundim të tij me personat përgjegjës, argumentet, provat dhe faktet e trajtuara në observacionet, dërguar nëpërmjet postes elektronike, janë reflektuar në raportet e auditimit mbajtur në çdo subjekt të audituar.

### **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:**

*Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme DVASHK Bulqizë, ZVASHK Tropoje dhe DRM Elbasan*, në zbatim të ligjit nr. 33, datë 21.3 2012 "Për regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme", nr.111/2018 "Për Kadastrën" i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, kanë për objektiv:

-Zbatimin e ligjshmërisë në regjistrimin, transaksionet e pasurive të paluajtshme sipas statusit juridik "Shtet" "Privat" bashkëpronësi, ruajtjen e paanësisë në çështjet e konflikteve gjyqësore, regjistrimin e pasurive publike, pa asnjë lloj diskriminimi të ndikuar nga statusi apo interesa të tjera, mbajtja e një qëndrimi të paanshëm e objektiv në dhënien e informacionit për statusin dhe gjendjen juridike të pasurive sidomos ndaj institucioneve që kanë si funksione ligjore, luftën kundër korrupsionit, verifikimin e titujve të pronësisë bujqësore, apo Legalizimin e objekteve informate si dhe shërbime të tjera bankare ndaj investitorëve dhe operatoreve të tjerë investitore te tregut.

-Shërbimin cilësor e me transparencë ndaj publikut dhe ndaj institucioneve publike për pasuritë publike në shërbim të komunitetit me status e vendndodhje qendrore ose vendore me interes dhe në funksion të publikut.

**Përgjegjësitë e DRM Elbasan**, ka përgjegjësi për veprime të licencimit të veprimtarive dhe pajisjen me leje mjedisore tip C, të subjekteve, pjesëmarrjen në dhënien e mendimeve për vlerësimin e ndikimit në mjedis për lejet tipi A,B, , kur i delegohet nga AKM Tiranë, administrimin evidentimin ndjekjen e procesit të vetmonitorimit nga subjektet e pajisur me leje mjedisore, të gjitha këto në zbatim të ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe gjithë paketën ligjore e nënligjore për mjedisin.

### **Përgjegjësitë e audituesve:**

Grupi i auditimit të KLSH<sup>së</sup>, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, grupi i auditimit ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, si dhe Standardet e Miratuara të Auditimit ka patur në qendër të vëmendjes:

Grupi i auditimit të KLSH<sup>së</sup>, për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas (ISSAI) të INTOSAI, (ISA) të IFAC,



## KONTROLLI I LARTË I SHTESTIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

ka zbatuar Kodin e Parimet Etike të cilat drejtojnë përgjegjësitë profesionale të audituesit, dhe Standardet e Miratuara të Auditimit, si dhe ka patur në qendër të vëmendjes kriteret e vlerësimit.

### **Kriteret e vlerësimit:**

Në të gjitha fazat e auditimit sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit, në referencë me problematikën është patur si kriter vlerësues në radhë të parë ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" si dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" etj. Udhëzimin e Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 "Mbi procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës në auditimin e verifikimit të zbatimit të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në vlerësimin e mekanizmave të auditimit, janë marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- kontrolli i zbatimit të afatit 20 ditor përcaktuar në pikën "j" të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"
- vlerësimi i procesit të monitorimit të zbatimit të rekomandimeve dhe raportimi në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, brenda afatit prej 6 muaj nga data e dërgimit të Raportit Përfundimtar të Auditimit, siç përcaktohet në pikën 2 të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"
- verifikimi i nxjerrjes së akteve administrative përkatësinë zbatim të pikës 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktive në njësitë e sektorit publik" kap. IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve",
- verifikimi i të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe procedurave të tjera ligjore me qëllim kërkimin e shpërblimit të dëmit.

### **Standardet e auditimit**

Rregullorja e Brendshme "Mbi Organizimin dhe Funksionimin Administrativ të Kontrollit të Lartë të Shtetit", miratuar me Vendim të Kryetarit të KLSH, Nr. 85, datë 30.06.2015; Rregullorja e Brendshme "Për procedurat e auditimit të KLSH"; miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.107, datë 08.09.2017, e ndryshuar, neni 42; Udhëzimi i Kryetarit të KLSH nr. 1, datë 04.11.2016 "Mbi Procedurat për ndjekjen dhe dokumentimin e punës, në auditimin e verifikimit zbatimit rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit"; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t" (ISSAI), "Standardet e Kontrollit të KLSH", "Manualeve" si dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.04.2020 "Mbi zhvillimin e veprimtarisë audituese gjatë kohëzgjatjes së fatkeqësisë natyrore" të Kryetarit të KLSH-së, udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre.

## **III. PËRSHKRIMI I I AUDITIMIT**

### **III.1. Në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit Elbasan**

#### **Nga auditimi i ushtruar rezultoi:**

Lidhur me gjetjet nga auditimi i KLSH-së për çdo pikë të rekomandimeve në lidhje me Raportin Përfundimtar të Auditimit për periudhën objekt auditimi nga data 01.09.2016 deri me 31.12.2018. në Drejtorinë Rajonale të Mjedisit (DRM) Elbasan është trajtuar në vijim:

Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 13/6, date 07/10/2019 janë lënë **15** rekomandime gjithsej, nga këto: **13** masa organizative dhe **2** masë "Të ardhura të munguara me vlerën **221 652 mijë lekë, ndarë: a. nga mos njoftimi në kohe nga DRM Elbasan në DRISHMPUT Elbasan dhe mos aplikimi i gjobave nga kjo e fundit (DRISHMPUT) ndaj 736 subjekteve për moskryerje e mos**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

raportim te vetë monitorimeve në vlerën **220,800,000 (736 x 300 mijë) lekë dhe b.** për mospagesën e tarifës vjetore të pajisjes me leje mjedisore C ne vlerën **852 mije leke.**

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është pasqyruar në tabelën përkatëse realizuar si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **13** masa organizative nga të cilat janë pranuar dhe janë realizuar plotësisht 11 masa, dhe nuk janë zbatuar **2** masa(nr.10,12.

Masa "Të ardhura të munguara ose masa me efekt negativ financiare" janë rekomanduar 2 masa (nr. B.1 dhe B.2), prej të cilave **1** masë zbatuar pjesërisht masa (B.2) lidhur me mos njoftimi në kohe nga DRM Elbasan në DRISHMPUT Elbasan dhe mos aplikimi i gjobave nga kjo e fundit (DRISHMPUT) ndaj 736 subjekteve për moskryerje e mos raportim te vetë monitorimeve në vlerën **220,800,000 (736 x 300 mijë) lekë dhe 1** mase pa zbatuar, masa(B.1) lidhur me mospagesën e tarifës vjetore të pajisjes me leje mjedisore C ne vlerën **852 mije leke.**

Masat disiplinore 5 masa nga "Vërejtje" nuk është dhënë masë nga Drejtori i Përgjithshëm AKM Tiranë'.

**Në përfundim konstatohet se:** Zyra Drejtorinë Rajonale të Mjedisit (DRM) Elbasan nuk ka zbatuar të gjitha rekomandimet të dërguar me shkresën nr. 13/6, datë 07/10/2019. Nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditmin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht ose të papranuara:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**10. - Gjetje nga Auditimi:** DRM Elbasan për periudhën raportuese tetor 2016 – teror 2018, ka dhënë **123 pëlqime me vlerësime të ndikimit në mjedis (VNM)** dhe **59 pëlqime** për leje mjedisore për licencimet të tipit (A), (B) nga AKM. Për këto DRM Elbasan nuk ka informacione nga AKM Tiranë për ecurinë e procedurës për **shumicën e praktikave të dhënies së mendimit**. Këto veprime janë në kundërshtim me urdhrin e Ministrit të Mjedisit nr. 1964, datë 13.11.2014"“Për miratimin e procedurave të administrimit dhe formatit të regjistrave të lejeve të mjedisit të tipit (A), (B) dhe (C)”.Të dhënat sipas tabelës së lartpërmendur të krahasimit të regjistrit të pëlqimeve për VNM dhe leje mjedisore tipi (A-B) për periudhën shtator 2016 – 31 dhjetor 2018(*Trajtuar më hollësisht në faqe 58-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1. Rekomandim 10.1-:** DRM Elbasan të kërkojë zyrtarisht nga AKM Tiranë, marrjen e të dhënave në lidhje me ecurinë e praktikave të dhënies së mendimeve për VNM<sup>-të</sup> e Lejet mjedisore tipi (A; B) me synim përditësimin në formë elektronike të regjistrit të lejeve tipi (A,B), sipas formatit standard të miratuar, zbatimin e afateve dhe procedurave ligjore, si dhe mundësimin e bashkëpunimit ligjor me strukturat e tjera si, DRISHMU, NJVQV<sup>-të</sup> dhe QKL (*Trajtuar më hollësisht në faqe 58-60 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).Menjëherë.

**12 - Gjetje nga auditimi:** DRM Elbasan për periudhën raportuese 01 shtator 2016 – 31 dhjetor 2018, në shqyrtimin e procedurave të pëlqimit mjedisor dhe miratimit të lejeve mjedisore tipi (C) ka shqyrtuar gjithsej **525** raste duke kërkuar mendim nga NJQV në **447** raste ( nga të cilat në **123** raste nuk ka përgjigje), ka dhënë pëlqim mjedisor në të gjitha rastet e shqyrtuara (në **182** raste) dhe ka miratuar **343** lejet Tip C pa marrë në **201** raste në total përgjigje nga NJQV-të . DRME ka vepruar në këtë rast në heshtje sipas të drejtës që i jep Kreu IV, VKM nr. 419, datë 25.06.2014, pika 2 dhe 3, ku citohet se: ".... brenda 3 ditëve pune nga data e marrjes së aplikimit, DRM dërgon një kopje të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

*aplikimit në NJVQV e cila jep mendimin e saj me shkrim brenda 3(tre) ditë pune....".(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-36 të Raportit të Auditimit*

**2.Rekomandimi12.1:** DRM Elbasan të marrë masa dhe të gjejë forma bashkëpunimi për miratimin e lejeve të subjekteve nga ana e NJVQV<sup>-të</sup> përkatëse, të komunikojë e sigurojë dhënien e mendimit nga ana e saj me shkrim brenda 3(tre) ditëve. Në mungesë të bashkëpunimit të plotë të dhënies së mendimit nga NJVQV<sup>-të</sup> brenda afatit 3 (tre) ditor, DRM Elbasan herë pas here për rastet e mosdhënies së mendimit të njoftojë zyrtarisht AKM Tiranë dhe Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit. *(Trajtuar më hollësisht në faqen 35-36 të Raportit të Auditimit Në vazhdimësi*

### **B- TE ARDHURA TE MUNGUARA**

**1 - Gjetje nga auditimi:** Për periudhën raportuese objekt auditimi DRM Elbasan ka pajisur dhe miratuar leje mjedisore të tipit (C) gjithsej **269** subjekte; nga të cilat kanë kryer pagesat e tarifave **244** subjekte në vlerë **408** mijë lekë, ndërsa nuk kanë arkëtuar dhe janë debitorë **25** subjekte. Kjo vlerë e cila konsiderohet e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit, si pasojë e mos arkëtimit të tarifës së Lejes tipi (C) është në mospërputhje me nenin 3/c dhe nenin 5 të VKM nr.417, datë 25.06.2014 "Për miratimin e tarifave të lejeve të mjedisit". Si pasojë e mos pagesës së tarifës së Lejes mjedisore tipi (C), nga subjektet e pajisur me leje mjedisore për periudhën raportuese objekt auditimi, apo edhe për periudhën nga krijimi institucionit të DRM-së me detyrime të mbartura, si edhe nga procesi i pezullimit të lejeve mjedisore për subjektet me status të pezulluar dhe me QKB për periudhën 01.09.2016, 2017, 2018, institucioni ka krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit në vlerën **852 mijë lekë** (628 mijë lekë+224 mijë lekë të prapambetura) *(Trajtuar në faqen 16-19 të Raportit të Auditimit).*

**1.1-Rekomandim:** DRM Elbasan të marrë masa për saktësimin e adresave dhe të njoftojë të **25** subjektet me leje Mjedisore tipi (C), të cilët nuk kanë bërë pagesën e tarifës vjetore ne **vlerën 852 mije leke** sipas kërkesave ligjore të përcaktuara dhe në kushtet e lejeve të Mjedisit. DRM Qarku Elbasan të marrë masa që subjektet të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në këtë qark dhe që janë të pajisur me Leje Mjedisit të Tipit (A, B dhe C) të paguajnë tarifën vjetore brenda 3 mujorit të II<sup>-të</sup> të vitit ushtrimor. Deri fund viti 2018. *(Trajtuar në faqen 16-19 të Raportit të Auditimit).*

#### **Deri me dhjetor 2020**

**2-Gjetje nga auditimi:** Sipas numrit të vetë-raportimeve monitoruese që nuk kanë plotësuar kriterin, pra numrin e vetëmonitorimeve brenda 6 mujorit, në zbatim të nenit 29 pika b (iii) i Ligjit nr. 10488 datë 14.07.2014 "Për lejet e mjedisit", për mosplotësimin e kushteve të lejes për plotësimin e vet-monitorimeve duhej të aplikoheshin masa bazuar tek pika iii), neni 29 i ligjit nr. 10448 "Për lejet e mjedisit", në gjoba nga 300 mijë deri 500 mije lekë. Nëse ISHMPUT do të kishte aplikuar gjobën minimale prej **300 mijë lekë** për **736** subjektet që nuk kanë realizuar detyrimin për vetmonitorim, llogaritet se ka një mosarkëtim në buxhet në shumën **220,800,000 (736 x 300 mijë)** lekë për këto subjekte të cilat do të ishin aktive *(Trajtuar në faqen 66-69 të Raportit të Auditimit).*

**2.1-Rekomandim:** DRM Elbasan te verifikojë statusin e **736** subjekteve mbi te cilët nuk është aplikuar gjoba minimale ne shumën **220,800,000 lekë**, për mos kryerjen e raportimin e vetemonitorimit për periudhën e auditimit dhe te ndjeke ne bashkëpunim me AKM dhe ISHMPUT Elbasan te gjitha procedurat ligjore për kryerjen e raportimin e vetemonitorimeve. Brenda nuajit mars 2020. *(Trajtuar në faqen 66-69 të Raportit të Auditimit).*

#### **Deri me dhjetor 2020**



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

### **B. MASA DISIPLINORE**

**C.1** Mbështetur në nenin 57 "Përgjegjësia për masat disiplinore", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", germa "b" e "ç" dhe nenin 59 "Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore" të Ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, në pikën 11 të VKM nr.115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", i kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të AKM Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës me status nëpunësi civil fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore "**Vërejtje**" për:

për **5 punonjës**:

1. Për z. *E Xh*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) e leje mjedisi
2. Për z. *L I*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) e leje mjedisi,
3. Për z. *A M*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) e leje mjedisi,
4. Për z. *F M*, me detyrë specialist Vlerësimi Ndikimi ne Mjedis (VNM) e leje mjedisi,
5. Për z. *F P*, me detyrë specialist monitorues,

### **III. 2. Në Zyrën Vendore të ASHK Tropojë (ish-ZVRPP) Tropojë**

Lidhur me gjetjet nga auditimi i KLSH-së për çdo pikë të rekomandimeve në lidhje me "Raportin Përfundimtar të Auditimit për periudhën objekt auditimi nga data **01.01.2017 deri me datë 31.12.2018** në ZVASHK Tropojë është trajtuar në vijim:

**Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 208/7, datë 07.08.2019 janë lënë 29 rekomandime gjithsej, nga këto: 26 masa organizative dhe 1 masë "Të ardhura të munguara nga mos llogaritja e kamatë vonesës" me vlerën 300,000 lekë.**

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është pasqyruar në tabelën si më poshtë:

- a. Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **26 masa organizative**, nga të cilat janë pranuar dhe janë realizuar plotësisht **11 masa ndërsa pjesërisht dhe në proces 5 masa (nr. 1,2,3,6, 9) 1 masë nuk është pranuar krejtësisht ndërsa 9 masa janë në proces vlerësimi deri në fund të majit 2020, nga grupet e punës për pranimin ose mospranimin e tyre dhe konsiderohen të pazbatuara deri datë 11.05.2020.**
- b. Masa "**Të ardhura të munguara nga mos llogaritja e kamatë vonesës**" **1 masë** e papranuar dhe porealizuar,
- c. **Masat disiplinore nga 2 masa "Vërejtje me shkrim" janë realizuar.**

**Në përfundim konstatohet se:** ZVASHK Tropojë nuk ka zbatuar të gjitha rekomandimet të dërguar me shkresën **nr. 208/7, datë 07.08.2019**. Nga auditimi i kryer për verifikimin dhe zbatimin e detyrave të rekomanduara në auditimin e mëparshëm, kanë rezultuar të pazbatuara, të zbatuara pjesërisht ose të papranuara:

### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje nga auditimi:** ZVRPP Tropojë, para periudhës së auditimit ka kufizuar (1998) pasurinë nr.138/71, pemëtoje 244 m<sup>2</sup>, ZK 2170, "Koçanaj", vol 2, faqe 121 në seksionin "E", pasi kjo pasuri "shtet" është okupuar nga M A M, por në seksionin "C" të KPP pasuria është fshirë me të kuqe, ndërsa poshtë saj ka korrektim me bojë të bardhë, përfundimisht pasuria në fjalë nuk pasqyrohet në



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

emër të asnjë pronari, prandaj lind e domosdoshme pasqyrimi i saj siç ishte më parë "shtet" (*Më hollësisht trajtuar në faqet 39-48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.Rekomandim:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ZV ASHK) Tropojë të marrë masa, që në bazë të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën", bazuar në shkeljet e konstatuara, të pasqyrojë në seksionin "C" të KPP pasurinë 138/71 "shtet", pemëtore 244 m<sup>2</sup>, ZK 2170, "Koçanaj", vol 2, faqe 121, ashtu siç ishte më parë "shtet".

Menjëherë

**2. Gjetje nga auditimi:** Para periudhës nën auditim, u konstatua se:

-Lista e trojeve 0001 të ZK 2170, "Koçanaj" është e parregullt, pasi në 22 raste kanë korrigjime në numrin e pasurisë, në sipërfaqen e truallit, në sipërfaqen e ndërtesës, në emrin dhe mbiemrin e pronarit. Gjithashtu, tek lista është fshirë numri 112, duke kaluar nga numri 111 tek 113, ndërsa volumi 3 paraqet faqe bosh të pa plotësuar, duke mos zbatuar rendin kronologjik.

Pranimi nga ZVRPP i listës trojeve "Koçanaj" me parregullsi është në kundërshtim me VKM nr.556, datë 23.10.2000 "Për dorëzimin e dokumentacionit në ZVRPP".

- Lista e trojeve në ZK 2170 kanë të pasqyruar 2-3 troje për çdo kryefamiljar me sipërfaqe mbi normën 300 m<sup>2</sup>. Kështu, në 6 raste pasuritë truall me sipërfaqe tepër + 1308 m<sup>2</sup>, janë çelur në KPP përkatëse, dukelëshuar certifikatat me sipërfaqe tepër dhe pa titull pronësie, pa i veçuar e regjistruar "shtet". Veprime në kundërshtim me ligjin nr.7501, datë 19.7.1991 "Për tokën", me ligjin nr.7843, datë 13.7.1994 "Për regjistrimin pasurive të paluajtshme", me nenin 23 e 25 të ligjit nr.33, datë 29.04.2012, me nenin 10 të Dekretit nr.5747, datë 29.6.1978, datë 29.6.1978 "Për hartimin, miratimin e zbatimin planeve rregulluese të qyteteve e fshatrave", me Rregulloren nr.184, datë 08.04.1999, ndryshuar me Rregullore nr.7, datë 07.01.2000 "Për punën e ZVRPP", konkretisht:

\* A H H paraqet pasurinë 1006, truall 300 m<sup>2</sup> (80 m<sup>2</sup> ndërtesë), vol 3, faqe 198, dhe pasurinë 1034, truall 300 m<sup>2</sup>, vol 3, faqe 204, si dhe pasurinë 1038, truall 300 m<sup>2</sup> (40 m<sup>2</sup> ndërtesë), vol 3, faqe 205, ose 600 m<sup>2</sup> truall tepër,

\* Sh K R paraqet pasurinë 255/12/1, truall 120 m<sup>2</sup> (120 m<sup>2</sup> ndërtesë), si dhe pasurinë 210, truall 300 m<sup>2</sup> (99 m<sup>2</sup> ndërtesë), ose 120 m<sup>2</sup> truall tepër,

\* A B paraqet pasurinë 325/6/1, truall 66 m<sup>2</sup> (66 m<sup>2</sup> ndërtesë) si dhe ka të shtuar nëpërmjet korrigjimit dhe zbardhimit me boje pasurinë 312/3, truall 300 m<sup>2</sup> (91 m<sup>2</sup> ndërtesë), ose 66 m<sup>2</sup> truall tepër,

\* I R R paraqet pasurinë 184/1, truall 80 m<sup>2</sup> (80 m<sup>2</sup> ndërtesë) dhe pasurinë 180/1, truall 300 m<sup>2</sup> (78 m<sup>2</sup> ndërtesë), ose 78 m<sup>2</sup> truall tepër,

\* Xh D paraqet të dubluar 2 herë në listën e trojeve pasurinë 296/2, truall 300 m<sup>2</sup> (80 m<sup>2</sup> ndërtesë) ose 300 m<sup>2</sup> truall tepër,

\* **S A M paraqet pasurinë 73, truall 300 m<sup>2</sup> (116 m<sup>2</sup> ndërtesë) si dhe ka të shtuar nëpërmjet korrigjimit pasurinë 77, truall 114 m<sup>2</sup> (11 4m<sup>2</sup> ndërtesë), ose 144 m<sup>2</sup> truall tepër (Më hollësisht trajtuar në faqet 39 - 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)**

**2. Rekomandimi :** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë, bazuar në nenin 27 të ligjit nr.111/2018 "Për Kadastrën", të nxjerrë urdhër kufizimi për 6 pasuritë truall me sipërfaqe tepër + 1308 m<sup>2</sup>, deri në saktësimin e listave trojeve Koçanaj në bashkëpunim me Bashkinë Tropojë, duke njoftuar brenda afatit ligjor poseduesit e paligjshëm të këtyre pasurive, në të kundërt të shfuqizojë certifikatat e lëshuara dhe të veçojë regjistrimin "shtet" të sipërfaqeve tepër.

**3. Gjetje nga auditimi:** Para periudhës nën auditim u konstatua në disa raste se: në kundërshtim me Udhëzimin Metodik 76, datë 13.9.1999 "Për plotësimin e KPP", regjistruesi dhe specialistët



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

paraqesin të meta e mangësi në mbajtjen e KPP të volumeve, konkretisht: vol 3, Bujan, ZK 1301, nuk është plotësuar sipas radhës në mënyrë kronologjike, pasi paraqet faqe bosh, përkatësisht faqja 51, 57 dhe 76. Ky volum paraqet korrigjime të numrit pasurisë, llojit pasurisë, emrit të pronarit, përkatësisht: faqe 38, 60, 102, etj. Veprime që bien ndesh me udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 "*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik* , pika 36 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 39 - 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.Rekomandimi:**Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë, bazuar në nenin 13 të ligjit nr.111/2018 "*Për Kadastrën*" dhe bazuar në shkeljet e konstatuara, të marrë masa për eliminimin e mangësive, në mbajtjen dhe plotësimin e volumit 3, ZK 1301 sipas kërkesave ligjore.

**6. Gjetje nga auditimi:**ZVRPP Tropojë, sipas referencave nr.7300 datë 09.08.2017, të ZK 3147 "*Bajram Curri*", ka kryer regjistrimin e vendimit gjykatës të shkallës së parë Tropojë nr.97, datë 23.05.2017 (*marrë formën e prerë 19.06.2017*), në emër të G B Gj, A B Gj, M B M, V B K dhe Xh S Gj, për sipërfaqen truall 10341 m<sup>2</sup>, për 9 pasuritë:

- nr. 8/116, sipërfaqe 1661 m<sup>2</sup> truall, vol 13, faqe 6, certifikatë pronësie datë 14.08.2017,
- nr. 2/95, sipërfaqe 646 m<sup>2</sup> truall, vol 14, faqe 45, certifikatë pronësie datë 14.08.2017,
- nr. 2/97, sipërfaqe 802 m<sup>2</sup> truall, vol 13, faqe 169, certifikatë pronësie datë 14.08.2017,
- nr. 2/171, sipërfaqe 326 m<sup>2</sup> truall, vol 13, faqe 19, certifikatë pronësie datë 14.08.2017,
- nr. 2/114, sipërfaqe 1831 m<sup>2</sup> truall, vol 14, faqe 154, certifikatë pronësie datë 11.07.2017,
- nr. 1/212, sipërfaqe 960 m<sup>2</sup> truall, vol 6, faqe 198, certifikatë pronësie datë 11.07.2017,
- nr. 4/9, sipërfaqe 378 m<sup>2</sup> truall, vol 12, faqe 41, certifikatë pronësie datë 11.07.2017,
- nr. 2/104, sipërfaqe 1476 m<sup>2</sup> truall, vol 12, faqe 119, certifikatë pronësie datë 11.07.2017,
- nr. 2/115, sipërfaqe 2261 m<sup>2</sup> truall, vol 12, faqe 117, certifikatë pronësie datë 11.07.2017.

ZVRPP Tropojë, nuk ka bërë rekurs në Gjykatën e Apelit brenda afatit prej 15 ditësh, për vendimin e gjykatës të shkallës së parë Tropojë nr.97, datë 23.05.2017, duke mos plotësuar elementet e formës dhe përmbajtjes të aktit administrativ, në zbatim të nenit 44-45 pika 5 të ligjit nr. 33, datë shtojcat 1,2 dhe 3, pikat 2-3 në zbatim të udhëzimit nr.2, datë 12.09.2012 dhe Kreun e IV-të të Rregullores nr.184, datë 08.04.1999.

Palë të paditura kanë qenë Bashkia Bajram Curri dhe ZVRPP Tropojë(*kjo e fundit edhe si palë e interesuar nuk ka marrë pjesë në shqyrtimin e vendimit gjykatës shkallës parë Tropojë*)(*Më hollësisht trajtuar në faqet 68 - 72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6. Rekomandimi :** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa në të ardhmen, në zbatim të ligjit nr.111/2018 "*Për Kadastrën*", neni 47 dhe 66 "*Pjesëmarrja e detyrueshme e ASHK-së në proceset gjyqësore*", bazuar në shkeljet e konstatuara të ndjekë të gjitha shkallët e proceseve gjyqësore, në të cilat ZVRPP Tropojë është palë e paditur ose e interesuar, në mbrojtjen e interesave të pronës publike.

**7. Gjetje nga auditimi:**Me referencën nr. 6965, datë 13.09.2018 është regjistruar pasuria 11/70 "*truall 825 m<sup>2</sup> nga kjo 80 m<sup>2</sup> ndërtesë -2 kat*", në emër të I R Gj, ZK 1347 "*Bajram Curri*", vol 8, faqe 91, me shkresën përmbartimore nr.744 datë 04.09.2018 për ekzekutim të vendimit gjykatës Tropojë nr.91, datë 02.05.2018 me paditës I R Gj dhe i paditur Bashkia dhe ZVRPP Tropojë, "*për njohjen pronar me parashkrim fitues mbi 1 shtëpi banimi dhe truall me posedim mbi 20 vjet*", certifikata datë 24.09.2018.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit konstatohet që:

**a.** Bashkia Tropojë nuk ka apeluar vendimin gjykatës Tropojë nr.91, datë 02.05.2018, sipas kërkesave të Kodit Procedurave Civile.



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETEVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

- b.** Nuk është verifikuar nëse Avokatura e Shtetit ka qenë palë në gjykim apo jo. Specialisti i praktikës nuk ka informuar regjistruuesin për njoftimin e Avokaturës shtetit.
- c.** Nga shqyrtimi i vendimit gjykatës Tropojë nr.91, datë 02.05.2018 rezulton se ZVRPP nuk është njoftuar, pasi nuk ka marrë pjesë në gjykim, *fakt ky që citohet në këtë vendim gjykate.*
- d.** Nuk ka relacion nga punonjësi që ka përpunuar praktikën, nuk janë plotësuar anekset 1,2,3.
- e.** Pasuria 11/70 nuk ka kufizim në KPP,
- k.** ZVRPP Tropojë nuk ka verifikuar elementet e formës të vendimit të gjykatës Tropojë, Veprimet bien në kundërshtim me pikën 7 të Udhëzimit nr. 2, datë 12.09.2012 *“Për përcaktimin e elementeve të akteve që verifikohen nga ZRPP dhe të procedurës për nxjerrjen urdhrit të regjistruesit” (Më hollësisht trajtuar në faqet 68 - 72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
- 7. Rekomandimi :** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa, në bazë të nenit 27 të ligjit nr. 111/2018 *“Për Kadastrën”* dhe nenit 66 *Pjesëmarrja e detyrueshme e ASHK-së në proceset gjyqësore*, bazuar në shkeljet e konstatuara: të vendosë masë kufizimi hipotekor të pasurisë nr.11/70, ZK 1347, vol 8, faqe 91, si dhe të njoftojë Avokaturën e Shtetit.
- 9. Gjetje nga auditimi:** Në kundërshtim me Udhëzimin Metodik nr.76, datë 13.9.1999 *“Për plotësimin e KPP”*, u konstatua se në 7 raste KPP e Dojanit, Tropojë, paraqesin të meta e mangësi në mbajtjen e tyre, pasi janë të korigjuara sipërfaqet, emrat e pronarëve dhe lloji i pasurisë, konkretisht:
- pasuria 29/19, ZK 1503, vol 2, faqe 187, paraqet korigjime në sipërfaqen arë 4700 m2 dhe emrin e pronarit R Z K, nuk ka transaksione dhe pajisje me certifikatë.
  - pasuria 51/3, truall 300 m2, ZK 1503, vol 2, faqe 191, paraqet ndryshime në emrin e pronarit, pasi nga M M që ishte, është pasqyruar M M B, pajisur me certifikatë pronësie 27.12.2017.
  - pasuria 51/4, ZK 1503, vol 2, faqe 192, paraqet korigjime në mbiemrin e pronarit B S H, nuk ka transaksione dhe pajisje me certifikatë pronësie.
  - pasuria 56/3, ZK 1503, vol 2, faqe 237, paraqet korigjime në emrin e pronarit Sh F B, nuk ka transaksione dhe pajisje me certifikatë pronësie.
  - pasuria 101/7, ZK 1503, vol 3, faqe 80, paraqitet e fshirë lloji i pasurisë truall duke e pasqyruar pemëtore në emrin e pronares A D, nuk ka transaksione.
  - pasuria 348/9, ZK 1503, vol 1, faqe 43, paraqet korigjime në sipërfaqen truall 150 m2 dhe në mbiemrin e pronarit B P, nuk ka transaksione, certifikatë pronësie 15.05.2017.
  - pasuria 12/6, ZK 1503, vol 1, faqe 119, paraqitet e korigjuar lloji i pasurisë truall duke e pasqyruar rrugë në emrin e pronarit “shtet”, nuk ka transaksione.
  - në 2 raste faqet 102 dhe 105, vol 3, Dojan, paraqiten bosh të paplotësuar.
- Theksojmë se KPP i përkasin periudhës para vitit 2016, por për efekt transaksioneve të mëvonshme, lind e domosdoshme sqarimi dhe saktësimi i tyre, që gabimi të mos mbartet (Më hollësisht trajtuar në faqet 10 - 48 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
- 9.Rekomandimi:.** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa, në bazë të nenit 13 dhe 26 të ligjit nr.111/2018 *“Për Kadastrën”*, bazuar në shkeljet e konstatuara,të marrë masa për eliminimin e mangësive në 7 pasuritë, përkatësisht nr. 29/19, 51/3, 51/4, 56/3, 101/7, 348/9 dhe 12/6, ZK 1503, Dojan, vol 2, faqe 187, 191, 192, 237, vol 3, faqe 80 dhe vol 1, faqe 43, 119, duke i saktësuar dhe pasqyruar ato në 7 KPP përkatëse sipas kërkesave ligjore.
- 11. Gjetje nga auditimi:** ZVRPP Tropojë, në 1 rast, në Zonën Kadastrale 3147 *“Rragom i Shalës”* sipas referencës 00000078, datë 18.05.2017, ka regjistruar AMTP dhe ka lëshuar mbi shtratin natyral të lumit *“Valbona”*, në sipërfaqen e përgjithshme prej 4823 m<sup>2</sup>, në një kohë që ujërat sipërfaqësore janë pasuri shtetërore e patjetërsueshme dhe e pa parashkrueshme, sipas ligjit për ujërat. Kjo AMTP,



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

nuk duhej të ishte lëshuar nga Bashkia Tropojë dhe nuk duhej të ishte regjistruar nga ZVRPP Tropojë.

Sa më sipër, Bashkia Tropojë për planvendosjet e dërguara dhe ZVRPP Tropojë për Hartat Treguese të Regjistrimit (HTR) fotokopje, nuk kanë kryer azhurnimin e të dhënave grafike me sistemin dixhital geoportal-albania, lidhur me pozicionimin e pasurisë së regjistruar, në raport me lumin "Valbona" dhe ZVRPP Tropojë nuk ka kryer korrigjim të HTR-së.

Këto mosveprime janë në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të ZQRPP nr. 184, datë 08.04.1999 "Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", Kreu III.

Sa më sipër është vepruar në kundërshtim edhe me ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 1, pika 2, germa "a"; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84, duke mos bërë verifikimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes bazuar në udhëzimin nr. 2, datë 19/09/2012, shtojca 3, pika 10.7, Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 44/2015, 30.04.2015, ku në nenin 107, citohet se:

*Akti administrativ është i ligjshëm nëse është nxjerrë nga organi publik kompetent, në përputhje me parimet dhe kërkesat ligjore të parashikuara në këtë Kod, si dhe legjislacionin në fuqi.*

Theksojmë se megjithë ndryshimet që ka pësuar ligji për ujërat, me ligjin nr. 6/2018, neni 5, pika 1/a, citon se:

*Janë në pronësi të shtetit dhe në administrim të organeve shtetërore: a) të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë*

*(Më hollësisht trajtuar në faqet 10 -96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.Rekomandimi:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë, të marrë masa bazuar në nenin 27 të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", duke vendosur kufizimin për pasurinë sipas referencës 00000078, datë 18.05.2017, deri në zgjidhjen e problemit të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe plotësimin të dokumentacionit tekniko-ligjor, në bashkëpunim me Bashkinë Tropojë, Autoritetet e Ujërave dhe institucione të tjera sipas ligjit, kalimin pronë "Shtet" të pjesës së lumit "Valbona" me mbivendosje dhe kompensimin e pronarit të tokës bujqësore.

**16. Gjetje nga auditimi:**ZVRPP Tropojë, në 2 raste, në Zonat Kadastrale: ZK 3649 "Aste", sipas referencës 00000023, për pasurinë 192/7 dhe 1347 "Bajram Curri", sipas referencës 00007084, për pasurinë 3/145/1, ka kryer regjistrimin e pasurive Truall 600 m<sup>2</sup> (Ndërtesë 141.5 m<sup>2</sup>), në kushtet e mungesës së dokumentit zyrtar të lëshuar nga organet e pushtetit vendor brenda kompetencave të tyre, që provon se ndërtimi është bërë para vitit 1991, në kundërshtim me germën "ç", pika 5, e VKM nr.608, datë 05.09.2012.

Pra, mungon dokumentacioni bazë për të kryer regjistrimin, pasi për të provuar që ndërtimi është bërë para vitit 1991, duhej të ishin paraqitur dokumente të kohës si: leje ndërtimi, harta treguese, preventiva, etj. dhe jo të mjaftohej vetëm me lëshimin e vërtetimit nga pushteti vendor (Bashkia Tropojë), kjo sepse është në tagrin e ZVRPP të kontrollojë imtësisht dokumentacionin në këtë rast (Më hollësisht trajtuar në faqet 10 -96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**16.Rekomandimi:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa bazuar në nenin 27 të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", duke vendosur kufizimin për pasuritë ZK 3649 "Astë", sipas referencës 00000023, për pasurinë 192/7 dhe 1347 "Bajram Curri", sipas referencës 00007084, për pasurinë 3/145/1, deri në plotësimin e dokumentit zyrtar të lëshuar nga organet e pushtetit vendor brenda kompetencave të tyre, dokumenta të kohës si: leje ndërtimi, harta treguese, preventiva, etj., që provojnë se ndërtimet janë bërë para vitit 1991.



## KONTROLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

**17. Gjetje nga auditimi:**Në 1 rast, në Zonën Kadastrale 3703 fshati Valbonë, sipas referencës nr.0149, ZVRPP Tropojë ka regjistruar leje ndërtimi për objekte me sipërfaqe 452m<sup>2</sup> në favor të Bashkisë Tropojë në Zonën e Mbrojtur të Valbonës. Nga kontrolli i dokumentacionit pjesë e dosjes, rezulton regjistrimi i kësaj pasurie është bërë me të meta e parregullsi si më poshtë vijon:

-Mungon dokumentacioni origjinal i lejes së ndërtimit dhe nga korrespondenca e të gjitha institucioneve përgjegjëse nuk rezulton që ndonjë institucion ta disponojë origjinalin e dosjes, apo të përmendet nëse fotokopjet e dërguara të lejes së ndërtimit, vendimit për miratimin e sheshit të ndërtimit etj janë të njësuara me origjinalin apo jo.

-Mungon Vendimi për Lejen e Ndërtimit dhe projekti arkitektonik i miratuar për lejen e ndërtimit. Veprim në kundërshtim me Udhëzim nr.1, datë 13.04.2016 "Për caktimin e kriterëve e të procedurave për regjistrimin e lejes së ndërtimit dhe akteve noteriale të lidhura për zhvillimin, në cilësinë e investitorit e të pronarëve të truallit apo blerësve/porositësve të njëjësive individuale, të objektit në fazën e karabinasë dhe të objektit të përfunduar"

-Mungon leja e mjedisit për këtë objekt nga institucionet përkatëse. Duke qenë se Lugina e Valbonës me Vendim nr.102, datë 15.01.1996 është shpallur Park Kombëtar i kategorisë së II-të IUCN, atëherë nga ZVRPP Tropojë duhet të ishte marrë parasysh edhe fakti, nëse është zbatuar neni 6 i ligjit nr.8906, datë 06.06.2002 "Për zonat e mbrojtura", i ndryshuar, sipas të cilit duhet të disponohet edhe leje mjedisi për objektin në fjalë. ZVRPP Tropojë nuk ka bërë verifikimin e elementëve të formës dhe përmbajtjes në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2, datë 12.09.2012 "Për përcaktimin e elementeve të akteve që verifikohen nga ZRPP dhe të procedurës për nxjerrjen urdhrat të regjistruarit",

-Ndër të tjera, kërkesa e regjistrimit të lejes së ndërtimit (datë 16.04.2010) është bërë me aplikim nr.824 më datë 09.07.2017, pra 7 vjet me vonësë. ZVRPP Tropojë, nuk ka llogaritur dhe nuk ka mbajtur kamatëvonësën për regjistrimin me vonësë të aktit administrativ në vlerën 300,000 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Ky veprim bie në kundërshtim me nenet 38 dhe 39 të Ligjit 33/2012 datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar.

-Përsa i përket marrëdhënieve me truallin, nga shqyrtimi i dokumentacionit të mësipërm nuk ka asnjë dokument për origjinën apo pronësinë e truallit mbi të cilin është ngritur objekti, e për pasojë u bë verifikimi i kartelës nga i cili rezulton se sipas shënimeve të bëra në kartelë truall prej 4180m<sup>2</sup> ka qenë i regjistruar në emër të Komunës Margegaj para daljes së lejes për sheshin e ndërtimit sipas referencë nr.0026, datë 19.10.2009 në vol.1 faqe 231, pasuri nr.100/33, lloji i pasurisë "Arë". Nga verifikimi i referencës nr.0026, datë 19.10.2009 rezulton se nuk ka asnjë lidhje me këtë pronë, por ka të bëjë me pasurinë nr.100/30 të llojit "Arë" me sipërfaqe 2875m<sup>2</sup>, të regjistruar në emër të RS në vol.1, faqe 157.

Për sa më lartë, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ka asnjë dokument pronësie që të vërtetojë regjistrimin e sipërfaqes 4180m<sup>2</sup> truall në emër të komunës Margegaj e cila më pas ka kaluar në pronësi të Bashkisë Tropojë sipas lejes së ndërtimit të trajtuar më sipër (*Më hollësisht trajtuar në faqet 10 -96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.Rekomandimi:** Zyrës Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", duke vendosur kufizimin për pasuritë e mësipërme deri në plotësimin e dokumentacionit të plotë tekniko-ligjor.

**18. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast, në Zonën Kadastrale 3703 fshati Valbonë,nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se kartela e pasurisë së paluajtshme e printuar nga sistemi, në vol.14 faqe 198, i ka të hedhura të dhënat e lejes së ndërtimit për shtesën anësore prej 21m<sup>2</sup>, certifikatë pronësie lëshuar më datë 04.10.2018. Por, specialisti i cili ka përpunuar praktikën nuk i ka hedhur këto të



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

dhëna në kartelën fizike, sepse në vol.14 faqe 198 rezulton e regjistruar vetëm sipërfaqja prej 21m<sup>2</sup> truall dhe jo shtesa e objektit e miratuar sipas lejes së ndërtimit (*Më hollësisht trajtuar në faqet 10 - 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**18.Rekomandimi:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë, të marrë masa për pasqyrimin e të dhënave të pasurisë trajtuar më sipër në kartelën fizike mbi bazën e titullit të pronësisë në zbatim të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën".

**22. Gjetje nga auditimi:**Në 1 rast, në Zonën Kadastrale 3703 fshati Valbonë, ZVRPP Tropojë ka regjistruar pasuri dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për sipërfaqen 4300m<sup>2</sup> të llojit "Arë" sipas AMTP-së. ZVRPP Tropojë duhet të kishte evidentuar pozicionimin e saktë të pasurive, aq më tepër kur nga fotokopjet e planvendosjeve nuk pasqyrohej pozicionimi i pasurive në raport me Lumin e Valbonës si dhe të bënte krahasimin e tyre me HTR. Nga verifikimi i hartës zyrtare dixhitale në sistemin ASIG Geoportal rezulton se pasuritë realisht nuk janë të llojit "Arë", por ndodhen në shtratin e Lumit Valbona, pra në rastin konkret kemi të bëjmë me tjetërsimin e shtratit të Lumit të Valbonës. Është vepruar në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit nr.111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar sepse shtrati i lumit është pasuri shtetërore e cila është e patjetërsueshme dhe pa parashkrueshme (*Më hollësisht trajtuar në faqet 10-96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**22.Rekomandimi:** Zyra Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa bazuar në ligjin nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën" dhe dispozitat ligjore që rregullojnë menaxhimin e ujerave, duke vendosur kufizimin për pasurinë e trajtuar më sipër deri në veçimin pronë "Shtet" të shtratit të lumit të Valbonës i ndarë si tokë bujqësore.

**23. Gjetje nga auditimi:**Në 1 rast, në Zonën Kadastrale 3703 fshati Valbonë, është regjistruar pas. nr.100/22/2 në favor të personave privatë vetëm sipërfaqja truall prej 150m<sup>2</sup> pa ndërtesë, ndërkohë që dispozitat ligjore përcaktojnë se trualli jepet vetëm me qëllimin e disponimit të një ndërtese mbi bazën e Listës së trojeve dhe ndërtesave 001.

Për sa më lartë, regjistrimi i kësaj sipërfaqe është bërë në mospërputhje me nenin 23 të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, nenin 24 të ligjit nr.33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, Rregulloren nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", e ndryshuar, Kreu IV, pika 13, si dhe me urdhrin e Kryeregjistruesit nr.3191, datë 11.05.2012 "Unifikimi i procedurave të regjistrimit të pasurive "Truall+Ndërtesë", në zonat urbane të fshatit, bazuar në aktet e lëshuara nga organet e pushtetit vendor bazuar në Dekretin nr.7011, datë 03.12.1985, "Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave.", VKM 432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ne zonën urbane të fshatit", të shfuqizuar" dhe VKM nr.159, datë 21.03.2006 (*Më hollësisht trajtuar në faqet 10 - 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**23.Rekomandimi:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa bazuar në dispozitat ligjore, duke vendosur kufizimin për pasurinë e trajtuar në Zonën Kadastrale 3703 fshati Valbonë, pas. nr.100/22/2 dhe të veçojë pasurinë e mësipërme pronë "Shtet".

**24. Gjetje nga auditimi:**Në 1 rast, në Zonën Kadastrale 3703 fshati Valbonë, ZVRPP Tropojë ka regjistruar dhe ka lëshuar certifikatë pronësie për pas. nr.32 me sipërfaqe 300m<sup>2</sup> truall dhe 105m<sup>2</sup> ndërtesë ndërkohë që në emër të të njëjtit person, sipas Listës së trojeve dhe ndërtesave 001 ishte regjistruar dhe lëshuar certifikatë pronësie për një pasuri tjetër me sipërfaqe 300m<sup>2</sup> truall dhe 77m<sup>2</sup>



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

ndërtesë. ZVRPP Tropojë nuk duhet të kishte vijuar me regjistrimin e pasurisë me sipërfaqe 300m<sup>2</sup> truall dhe 105m<sup>2</sup> ndërtesë, por duhet ta kishte kufizuar atë për shkak se mbi bazën e nenit 6 të Dekretit nr.7011, dt. 03.12.1985, "Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave."ku lejohej të merrej për qëllimin e ndërtimit të banesës vetëm një ngastër deri në sipërfaqen truall 300m<sup>2</sup> në fshatrat malorë.

Për sa më lartë, regjistrimi është kryer në mospërputhje me nenin 24 të ligjit nr.33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, Rregulloren nr.184, datë 08.04.1999 "Për punën e zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme", e ndryshuar, Kreu IV, pika 13, si dhe me urdhrin e Kryeregjistruesit nr.3191, datë 11.05.2012 "Unifikimi i procedurave të regjistrimit të pasurive "Truall+Ndërtesë", në zonat urbane të fshatit, bazuar në aktet e lëshuara nga organet e pushtetit vendor bazuar në Dekretin nr.7011, datë 03.12.1985, "Për hartimin, miratimin dhe zbatimin e planeve rregulluese të qyteteve dhe të fshatrave", VKM nr.432, datë 14.08.1995 "Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme ne zonën urbane të fshatit", të shfuqizuar" dhe VKM nr.159, datë 21.03.2006 (Më hollësisht trajtuar në faqet 10 - 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**24.Rekomandimi:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa bazuar në dispozitat ligjore, duke vendosur kufizimin për pasurinë e trajtuar në Zonën Kadastrale 3703 fshati Valbonë, pas. nr.32 dhe të veçojë pasurinë e mësipërme pronë "Shtet".

**25. Gjetje nga auditimi:** Në 1 rast, në ZK 1617 qyteti Fierzë, ish-Regjistruesi i ZVRPP Tropojë ka nxjerrë urdher për heqjen e kufizimit për pasurinë me sipërfaqe 930m<sup>2</sup> truall dhe 304m<sup>2</sup> ndërtesë me arsyetimin se është plotësuar dokumentacioni tekniko-ligjor për të cilin është vendosur më parë kufizimi. Nga verifikimi rezultoi se nuk është plotësuar dokumentacioni i plotë tekniko ligjor i kërkuar, pra asnjë prej arsyeve për të cilat është vendosur kufizimi sipas urdhrin "Për regjistrim kufizimi" me nr.prot.967, datë 13.06.2014 ku arsyetohet se "Mungon dosja e plotë e lejes së ndërtimit, vendimi për sheshin e ndërtimit, plan vendosja e miratuar, planimetritë e miratuara, plani i rievimit, akti i kolaudimit është i paplotë, mungon marrëdhënia juridike midis investitorit dhe subjektit ndërtues. Mungon dosja e plotë dhe e konfirmuar e VKKP. Dëshmia e trashëgimisë për Zoje Ramaj nuk është origjinale. Për objektin ka diferencë dok-fakt=218.7m<sup>2</sup>". Veprim në kundërshtim me urdhrin "Për regjistrim kufizimi" me nr.prot.967, datë 13.06.2014 të nxjerë nga ai vetë, me ligjin nr. 33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, si dhe Rregulloren nr.184, datë 08.04.1999 "Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", i ndryshuar.

Ndër të tjera, rezultojnë se urdhri nr.27, datë 23.08.2017 për heqjen e kufizimit është nxjerrë nga ish-regjistruesi Xh Ç në një kohë që ai ka qenë i shkarkuar nga detyra e regjistruesit një ditë më parë me urdher të Ministrisë të Drejtësisë nr.4925/11, datë 22.08.2017. Veprim në kundërshtim me urdhrin e Ministrisë ku urdhërohet shkarkimi nga detyra e Regjistruesit të ZVRPP Tropojë të cilit i ndërpriten marrëdhëniet financiare menjëherë dhe dorëzimet përkatëse sipas ligjit të bëhen jo më vonë se data 23.08.2017. Pra, në rastin konkret urdhri nr.27, datë 23.08.2017 për heqjen e kufizimit duhet të konsiderohet si absolutisht i pavlefshëm për shkak se më datë 23.08.2017 ish-regjistruesi Xh Ç ka qenë i shkarkuar nga detyra dhe nuk ka patur kompetencë ligjore për të vepruar. Për sa më lartë është vepruar në kundërshtim me nenin 107 dhe nenin 108, germa a/i e Ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të RSH", i i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në faqet 10 deri 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**25.Rekomandimi:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", duke vendosur kufizimin për



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

pasurinë e trajtuar në ZK 1617 qyteti Fierzë me sipërfaqe 930m<sup>2</sup> truall dhe 304m<sup>2</sup> ndërtesë, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

**26. Gjetje nga auditimi:**Në 1 rast, në ZK 1617 qyteti Fierzë, ish-regjistruesi ka nxjerrë urdhër për heqjen e kufizimit për pasurinë me sipërfaqe 437m<sup>2</sup> truall në kundërshtim me urdhrin "Për regjistrim kufizimi" me nr.prot.961, datë 13.06.2014 të nxjerrë nga ai vetë, me ligjin nr.33/2012, datë 29.04.2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar, si dhe Rregulloren nr.184, datë 08.04.1999"Për Punën e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme", i ndryshuar sepse nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk rezulton të jetë plotësuar dokumentacioni i plotë tekniko ligjor me vendimin origjinal te KKKP apo të njësuar, arsye kjo për të cilën është vendosur kufizimi (Më hollësisht trajtuar në faqet 10 - 96 të Raportit

**26.Rekomandimi:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa bazuar në nenin 27 të ligjit nr. 111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", duke vendosur kufizimin për pasurinë e trajtuar në ZK 1617 qyteti Fierzë me sipërfaqe 437 m<sup>2</sup> truall deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko ligjor.

## **B. TË ARDHURA TË MUNGUARA**

**1.Gjetje nga auditimi:**Në 1 rast në Zonën Kadastrale 3703 fshati Valbonë kërkesa e regjistrimit të lejes së ndërtimit (datë 16.04.2010) është bërë me aplikim nr. 824 më datë 09.07.2017, pra 7 vjet me vonesë. ZVRPP Tropojë, nuk ka llogaritur dhe nuk ka mbajtur kamatë vonesën për regjistrimin me vonesë të aktit administrativ në vlerën 300,000 lekë që përbën të ardhura të munguara në buxhetin e shtetit. Ky veprim bie në kundërshtim me nenet 38 dhe 39 të Ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar (Më hollësisht trajtuar në faqet 10 deri 96 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.Rekomandimi:** Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tropojë të marrë masa, bazuar në nenin 27 të ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 "Për Kadastrën", të vendosë kufizim, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë në Zonën Kadastrale 3703 fshati Valbonë kërkesa e regjistrimit të lejes së ndërtimit (datë 16.04.2010) për të cilën është bërë me aplikim nr.824 më datë 09.07.2017, deri në arkëtimin në favor të shtetit të detyrimeve të përcaktuara në vlerën 300,000 lekë dhe deri në plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor përkatës.

### **4. Në Drejtorinë Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) Bulqizë**

Lidhur me gjetjet nga auditimi i KLSH-së për çdo pikë të rekomandimeve në lidhje me "Raportin Përfundimtar të Auditimit për periudhën objekt auditimi nga data 01.07.2017 deri me 31.12.2018. në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) Bulqizë është trajtuar në vijim: Nga ana e KLSH me shkresën përcjellëse nr. 207/7, datë 14.8.2019 janë lënë **50** rekomandime gjithsej, nga këto: **49** masa organizative dhe **1** masë "Të ardhura të munguara nga mos likuidimi qerasë për dy persona" me vlerën **341,560 lekë** dhe **3** masa disiplinore nga "Vërejtje" deri ne "Largim nga puna".

Nga verifikimi i dokumentacionit konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është pasqyruar në tabelën përkatëse realizuar si më poshtë:

Për përmirësimin e gjendjes janë lënë **49** masa organizative nga të cilat janë pranuar dhe janë realizuar plotësisht **49**, ndërsa janë realizuar pjesërisht **1** masë të ardhura të munguara nga



## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT  
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI "MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA" ne DVASHK BULQIZË,  
ZVASHK TROPOJË DHE DRM ELBASAN

mos likuidimi qerasë për dy persona” me vlerën **341,560 lekë, është vendosur kufizimi mbi pasuritë deri në likuidimit të vlerës më sipërme .**

Masat disiplinore nga 3 masa nga “Vërejtje” deri ne”Largim nga puna” është realizuar 1 mase (“Largim nga puna” ndaj z. Sh. A., me detyre ish-Regjistrues/Përgjegjës Zyre)”, ndërsa për 2 punonjës nuk është dhënë masë nga Drejtori i Përgjithshëm ASHK Tiranë’.

**Konkluzion:** Drejtoria Vendore Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (DVASHK) Bulqizë, (ish-ZVRPP Bulqizë) ka pranuar hartuar planin e masave për zbatimin në nivelin 100% të rekomandimeve, ka ndjekur dhe raportuar ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe ka realizuar në afatet e përcaktuara, ne nivelin 100% përkatësisht: 49 masa organizative kundrejt 49 të kërkuara e të pranuar, 1. Masë të ardhura të munguara (përfashtuar 3 masat disiplinore të cilat i janë kërkuar ASHK Tiranë kompetence e së cilës janë, në zbatim të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014. ”Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”

### IV. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

1. Aktverifikimi Nr. 1, datë 12.5.2020 “Mbi zbatimin e rekomandimeve” ne format elektronik dhe te shkruar
2. Kërkesa “Për dërgim dokumentacioni ne format elektronik” të grupit të auditimit të KLSH dërguar me email datë 27.4.2020, subjekti DRM Elbasan
3. Aktverifikimi Nr. 2, datë 07.5.2020 “Mbi zbatimin e rekomandimeve” ne format elektronik
4. Kërkesa “Për dërgim dokumentacioni ne format elektronik” të grupit të auditimit të KLSH dërguar me email datë 27.4.2020, subjekti ZVASHK Tropojë.
5. Email ZVASHK Tropojë dërguar datë 11 maj 2020, në lidhje me Aktverifikimin nr. 2, datë 07.05.2020, (urdhrat dhe KPP të skanuara).
5. Aktverifikimi Nr. 1, datë 07..5.2020 “Mbi zbatimin e rekomandimeve” ne format elektronik
7. Kërkesa “Për dërgim dokumentacioni ne format elektronik” të grupit të auditimit të KLSH dërguar me email datë 27.4.2020, subjekti ZVASHK Bulqizë.

**Shënim:** Të gjithë punonjësit që atakohen në këtë Raport auditimi duhet t’u bëhet prezent mangësitë dhe problemet për të cilat mbajnë përgjegjësi, mundësisht t’u jepen fotokopje të dokumentacionit që ka lidhje me ta, në mënyrë që të njihen dhe të bëjnë komentet dhe shpjegimet përkatëse, nëse kanë.

### GRUPI I AUDITIMIT

Selfo **ZENELI**, Përgjegjës grupi  
Aleksandër **PAPADHIMITRI**, Auditues,  
Artan **VOKSHI**, Auditues

## KONTROLLI I LARTË I SHTETIT